



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Predato Received / Delivery	29.08	2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSACK	5852	2023	115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1003/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1003/2023 të datës 18.07.2023, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë rruga " _____", në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1003/2023 e datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja _____.
- II. **Anulohet** Vendimi me Nr. 1133/2023 i datës 12.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. **Obligohet** Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.
- IV. **Obligohet** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Policisë së Kosovës më date 05.07.2023 ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme se ankuesja është intervistuar në cilësinë e të dyshuarës për shkak të dyshimit për Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrje e ryshfetit.

Sekretarja e Përgjithshëm e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndaj ankueses punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. prot: 80 të datës 25.11.2013 në pozitën "Koordinatorë e Projekteve të Arkitekturës dhe Ndërtimitarisë", në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 10.07.2023 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 12.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1133/2023 përmes të cilit ka bërë pezullimin nga marrëdhënies e punës së ankueses deri në marrjen e një vendimi tjetër dhe e njëjta do të kompensohet në vlerën prej 50% të pagës së plotë duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për periudhën e pezullimit deri në gjashtë (6) muaj.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 18.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5265/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 25.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5265/2023 të parashtruar nga ankuesi me datë 18.07.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 25.07.2023; Akt Emërimit me Nr. prot: 80 të datës 25.11.2013; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.01.2023 dhe 31.01.2022; Emailin nga F.T; Emailin e datës 05.07.2023 nga L.I për F.T; Emailin e datës 04.07.2023 nga F.T për L.I; Informimin e datës 11.07.2023; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 12.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që pjesërisht të aprovohet ankesa dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse:*

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 12.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 1133/2023 përmes të cilit ka bërë pezullimin nga marrëdhënies e punës së ankueses deri në marrjen e një vendimi tjetër dhe

e njëjta do të kompensohet në vlerën prej 50% të pagës së plotë duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për periudhën e pezullimit deri në gjashtë (6) muaj, në mbështetje të nenit 25 paragrafi 2, nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 1, nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3, 4, 7 dhe 10, nenit 55 paragrafi 1 nën paragrafi 1, nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1, nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave mbi bazë të të cilave është vendosur nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, konstaton se neni 55 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil"*, po ashtu neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji. 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi"*, neni 48 paragrafi 5 i të njëjtit ligj, përcakton se: *"Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar"*, ndërsa neni 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj"*.

Andaj duke iu referuar akteve normative të lartcekura si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor ka diskrecion që të pezullojë nga puna nëpunësin civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, mirëpo vetëm për periudhën kohore sa zhvillohet procedura disiplinore, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar, nga rrjedh se kuptimi i kësaj norme ndërlidhet me përfundimin e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen brenda afateve të përcaktuara kohore siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për iniciim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*.

Andaj nisur nga dispozitat ligjore të analizuara si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023 lidhur me pezullimin nga marrëdhënia e punës së ankueses me 50% të pagës deri në gjashtë (6) muaj, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një vendimmarrje të tillë, ngase Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështja e institutit të pezullimit të marrëdhënies së punës e rregulluar me nenin 56 të i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka përcaktuar nëntë (9) raste kur nëpunësit civil mund të pezullohen nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, dhe nga të gjitha këto vetëm për një (1) rast i është rezervuar e drejta

diskrecionale Komisionit Disiplinor që të pezullojë nëpunësin civil sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në rastet kur ndaj të njëjtit hapet apo iniciohet procedurë disiplinore nga Komisioni Disiplinor, mirëpo vetëm deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar që zgjidh çështjen juridike brenda afateve kohore të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se Vendimi me Nr. 1133/2023 i datës 12.07.2023 i Komisionit Disiplinor nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, ngase përmes të njëjtit nuk është zgjedhur çështja juridike e iniciuara sipas kërkesës së datës 10.07.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore, gjegjësisht me vendimin e njëjtë nuk është konfirmuar nëse ankuesi ka kryer shkelje disiplinore apo jo.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 1133/2023 të datës 12.07.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material si dhe kompetencat e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe mbi këtë bazë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke qenë se Vendimi me Nr. 1133/2023 i datës 12.07.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj rastin e ankuesit lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe vërejtjet e dhëna nga Kolegji i Këshillit sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Keshtu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1003/2023, datë 29/08/2023

Avdyr BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.